ELSIG
KOMPANIA E SIGURIMEVE / INSURANCE COMPANY
KOSOVA
Nr. 215 Dt. 27.04.2017

# KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.

## Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2016

**PËRMBAJTJA** **FAQE**


| | |
|---|---|
| RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR | 1 |
| PASQYRA E POZICIONIT TË KOMPANISË | 4 |
| PASQYRA E FITIMIT APO HUMBJES DHE TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE | 5 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE EKUITET | 6 |
| PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË | 7 |
| SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE | 8 - 35 |
| ANEKS A – PASQYRAT PLOTËSUESE | |
| ANEKS B - RAPORTI I AKTUARIT | |

Tel: +381 38 221 172
Fax: +381 38 221 170
www.bdokosovo.com

BDO Kosova L.L.C.
Rr. Pashko Vasa Nr. 46
10000 Prishtina Kosova

# RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

**Për menaxhmentin dhe aksionarët e ELSIG SH.A.**

## Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të ELSIG SH.A ("Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2016, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

BDO Kosova L.L.C. is a member of BDO International Limited, a UK company limited by guarantee, and forms part of the international BDO network of independent member firms.
BDO is the brand name for the BDO network and for each of the BDO Member Firms.

BDO

## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojm mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

**Raportet tjera për kërkesat e autoritetit mbikëqyrës, Bankës Qendrore të Kosovës, për Margjinën e Solvencës dhe Asetet që Konsiderohet për të Mbuluar Obligimet e Sigurimeve .**

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), neve kemi lexuar Pasqyrat Plotësuese të bashkangjitura për Margjinën e Solvencës dhe Asetet që Konsiderohet për të Mbuluar Obligimet e Sigurimeve ("Pasqyrat Plotësuese"). Këto Pasqyrat Plotësuese të përgatitura nga ana e Menaxhmentit nuk janë pjesë e pasqyrave financiare shoqëruese. Informacione historike financiare të paraqitura në tabelat shtese përgatitur nga menaxhmenti, janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin vjetor financiar shpalosura në pasqyrat financiare shoqëruese të Kompanisë më 31 Dhjetor 2016, të përgatitura në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme për kompanitë e sigurimeve në Kosovë.

Menaxhmenti është përgjegjës për të përgatitur Pasqyrat Shtesë në pajtim me Rregulloren e BQK-së të datës 30 Prill 2015, mbi depozitimin e aseteve si garanci, mjaftueshmërisë së kapitali, raportimit financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetit

BDO Kosova L.L.C.

**BDO Kosova L.L.C.**
19 Prill 2017
Rr. Pashko Vasa,. Nr. 46
10 000 Prishtinë, Kosovë

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar
Më 31 Dhjetor 2016

| | Shënim | Më 31 Dhjetor 2016 (në Euro) | Më 31 Dhjetor 2015 (në Euro) |
|---|---|---|---|
| **ASETET** | | | |
| Paraja në dorë dhe në bankë | 7 | 181,029 | 1,161,154 |
| Investimet në depozita | 8 | 6,724,039 | 5,771,801 |
| Investimet në letra me vlerë | 9 | 3,342,170 | 3,368,595 |
| Pjesa e ri-siguruesit për detyrimet e sigurimeve | | 775,413 | 230,314 |
| Kostot e përvetësuara të shtyra | 10 | 1,044,954 | 828,541 |
| Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet | 11 | 1,112,908 | 972,597 |
| Asetet e tjera | 12 | 1,013,141 | 906,654 |
| Prona dhe pajisjet | 13 | 342,328 | 291,106 |
| Asetet e paprekshme | 14 | 6,495 | 6,495 |
| **GJITHSEJ ASETET** | | **14,542,477** | **13,537,257** |
| **DETYRIMET** | | | |
| Humbjet dhe shpenzimet e korrigjimit të humbjes (rezervat teknike) | 15 | 4,705,843 | 4,512,183 |
| Primet e pa fituara | 16 | 4,229,678 | 3,868,983 |
| Llogaritë e pagueshme të sigurimit | 17 | 329,336 | 177,657 |
| Llogarite e tjera te pagueshme | 18 | 252,749 | 334,318 |
| **GJITHSEJ DETYRIMET** | | **9,517,606** | **8,893,141** |
| **KAPITALI AKSIONAR** | | | |
| Kapitali aksionar | 19 | 4,333,080 | 4,333,080 |
| Fitimi i akumuluar | | 691,791 | 311,036 |
| **GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR** | | **5,024,871** | **4,644,116** |
| **GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI** | | **14,542,477** | **13,537,257** |

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 19 Prill 2017.

Rexhep Idrizaj
Drejtor Gjeneral

Valon Berisha
Drejtor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

| | Shënim | Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (në Euro) | Për fund vitin 31 Dhjetor 2015 (në Euro) |
|---|---|---|---|
| Bruto primet e shkruara | 20 | 7,101,829 | 6,596,693 |
| Minus: Tatimi ne prime | | (355,091) | (329,835) |
| Minus: Primet e lëshuara ri-siguruesve | | (438,439) | (266,623) |
| **Neto primet e shkruara** | | **6,308,299** | **6,000,235** |
| Ndryshimi neto i rezervave për primet e pa fituara | 16 | (360,695) | (211,674) |
| Pjesa e ri-sigurueseve ne ndryshimin neto te rezervave për primet e pa fituara | | 522,325 | 50,142 |
| **Primet neto të fituara** | | **6,469,929** | **5,838,703** |
| Përqindja e të hyrave dhe shpenzimeve nga BKS | 21 | 786,204 | 1,216,353 |
| Komisioni nga ri-siguruesit | | (37,654) | (45,788) |
| Të hyrat nga interesi | | 324,841 | 315,628 |
| Të hyrat tjera | | 131 | 174,490 |
| **Gjithsej të hyrat** | | **7,543,451** | **7,499,386** |
| Humbjet dhe shpenzimet e korrigjimit te humbjeve (rezervat teknike) | 15 | (2,333,950) | (2,825,286) |
| Pjesa e shpenzimeve nga BKS | 21 | (293,816) | (307,320) |
| Kontributet për Fondin e Kompensimit | 22 | (538,695) | (401,549) |
| Kostot e përvetësuara të shtyra diferenca (DAC) | 10 | 216,413 | 79,253 |
| Shpenzimet administrative dhe të marketingut | 23 | (4,120,620) | (3,450,621) |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | 13&14 | (92,028) | (63,711) |
| **Gjithsej humbjet dhe shpenzimet** | | **(7,162,696)** | **(6,969,234)** |
| **Fitimi/(Humbja) për vitin** | | **380,755** | **530,152** |
| Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse | | | - |
| **Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin** | | **380,755** | **530,152** |

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

| | Kapitali aksionar | Fitimet e mbajtura (në Euro) | TOTALI |
|---|---|---|---|
| Bilanci më 1 Janar 2015 | 4,333,080 | (219,116) | **4,113,964** |
| Fitimi për vitin | - | 530,152 | **530,152** |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse | - | - | - |
| **Bilanci më 31 Dhjetor 2015** | **4,333,080** | **311,036** | **4,644,116** |
| Bilanci më 1 Janar 2016 | 4,333,080 | 311,036 | 4,644,116 |
| Fitimi për vitin | - | 380,755 | 380,755 |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse | - | - | - |
| **Bilanci më 31 Dhjetor 2016** | **4,333,080** | **691,791** | **5,024,871** |